



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2019:252458
Datë: 26.03.2024
Numri i dokumentit: 05507718

C.nr.423/2019

Gjykata Themelore Gjakovë-Dega e Gjykatës në Malishevë, Departamenti i Përgjithshëm/ Divizioni Civil, gjyqtari Petrit Curri në çështjen juridike kontestimore të paditësit X. Z. nga fshati Ll., Komuna e Malishevës, të cilin me autorizim e përfaqëson Av. Agron Kryeziu nga Malisheva, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Scardian” me seli në Prishtinë rruga “Perandori Justinian” nr.69, me objekt kontesti: ”Dëmshpërblim”, vlera e kontestit 1,500.00 euro, jashtë seancës gjyqësore me datë 26.03.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSTATOHET se paditësi X. Z. e ka tërhequr padinë që identifikohet në këtë gjykatë me shenjën C.nr.423/2019 të datës 31.10.2019, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Scardian” me seli në Prishtinë rruga “Perandori Justinian” nr.69.

A r s y e t i m

Paditësi X.Z. përmes të autorizuarit të tij av.Agron Kryeziu nga Malisheva, me datë 31.10.2019 në këtë gjykatë ka ushtruar padi kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Scardian” me seli në Prishtinë, me objekt kontesti: “Dëmshpërblim-Kompensim dëmi” me vlerë 1,500.00 euro.

Përfaqësuesi i paditësit, me datë 05.03.2024 e ka dorëzuar në këtë gjykatë parashtrësën për tërheqjen e padisë në këtë çështje juridiko-kontestimore, duke e njoftuar gjykatën se me të paditurën Kompaninë e Sigurimeve “Scardian” me seli në Prishtinë, kanë lidhur marrëveshje jashtëgjyqësore për kompensimin e dëmit, andaj kanë kërkuar tërheqjen e padisë së parashtruar pranë kësaj gjykate.

Gjykata vlerëson se konform nenit 3 të LPK-së, i cili i referohet parimit të disponibilitetit, palët mund të disponojnë lirisht me kërkesat e parashtruara në procedurë kontestimore, përfshirë edhe tërheqjen e padisë, veprim ky i përcaktuar me dispozitën nga neni 261 par.1 të LPK-së, e cila parasheh që: *“Paditësi mund ta tërheqë padinë pa pëlqimin e të paditurit deri në momentin në të cilin i padituri e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi”*.

Bazuar në faktin se paditësi e ka tërhequr padinë para se të paditurës t'i dërgohet padia me shkresat e lëndës për përgjigje në padi, e në rastin konkret nuk kërkohet pëlqimi i të njëjtit, gjykata vlerëson se janë përmbushur prezumimet procedurale për të vepruar konform dispozitës nga neni 261 par.3 të LPK-së, e cila përcakton se: *“Po që se padia është tërhequr, gjykata jep aktvendim me të cilin konstatohet se është tërhequr padia. Ky aktvendim i dërgohet të paditurit vetëm po që se padia i është dorëzuar me parë”*.

Prandaj duke u gjendur në një gjendje të këtyllë, gjykata në kuptim të dispozitave nga neni 261 lidhur me nenin 387.1 pika c, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata Themelore Gjakovë-Dega e Gjykatës në Malishevë
Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil
C.nr.423/2019, datë 26.03.2024

Gj y q t a r i
Petrit Curri

Udhëzim juridik: *Kundër këtij Aktvendimi, nuk është e lejuar ankesa konform nenit 261 par. 4 të LPK-së.*